



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 13.9.2024, miratoi këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE
“KUZHINA QENDRORE”, SHA, NË PRISHTINË

I

MIRATOHET Vendimi për lejimin e mjeteve NPL “Kuzhina Qendrore”, SHA, në Prishtinë.

II

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi është 129.624.00 euro, shumë kjo e siguruar nga Drejtoria e Administratës 16306, kategoria e subvencioneve - 200.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Financave dhe Drejtoria e Arsimit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/04-122014/24, më 16.09.2024

